

Kapitulli 3 Figura dhe personalitete

NGA KONGRESI I MANASTIRIT TE REPREZALJET E REGJIMIT KOMUNIST

PHD (c) Dorina DAIU, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojave të Komunizmit,
dorinadaiu@yahoo.com

Prof. Dr. Rudina MITA, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Rudina.Mita@uniel.edu.al

Abstrakt

Kongresi i Manastirit, i mbajtur në nëntor të vitit 1908, përfaqëson një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë shqiptare moderne, duke vendosur themelet e unifikimit të alfabetit të gjuhës shqipe dhe duke shërbyer si moment kyç në përmbushjen e objektivave të Rilindjes Kombëtare. Kjo kumtesë synon të hedhë dritë për herë të parë mbi fatin e disa prej delegatëve pjesëmarrës dhe familjeve të tyre gjatë periudhës së regjimit komunist në Shqipëri (1945–1991). Në këtë periudhë, e shënuar nga represioni politik dhe rishkrimi ideologjik i historisë, shumë prej figurave që kishin kontribuar në procese kyçe të ndërtimit të identitetit kombëtar u përjashtuan nga narrativa zyrtare, ndërsa familjarët e tyre u përballën me ndjekje dhe persekutim. Studimi përqendrohet në tri shtylla: roli i delegatëve në ndërtimin e identitetit kulturor shqiptar; trajtimi i familjarëve të tyre nga regjimi; dhe përpjekjet për fshirjen ose deformimin e kontributit të tyre historik. Kërkimi mbështetet në burime arkivore të paeksploruara dhe në dëshmi gojore nga trashëgimtarë të drejtpërdrejtë. Kjo qasje synon të risjellë në vëmendje figura të lëna në hije dhe të reflektojë mbi ndikimin e ideologjisë në ndërtimin e historisë kombëtare.

Fjalë çelës: Kongres, Delegatë, regjim komunist, identitet kombëtar, burime arkivore.

From the Manastir Congress to the Repressions of the Communist Regime

Abstract

The Congress of Manastir, held in November 1908, marks one of the most significant milestones in modern Albanian history. It established the foundation for the unification of the Albanian alphabet and served as a key turning point in advancing the aims of the Albanian National Awakening. This paper aims to shed light—for the first time—on the fate of several delegates who participated in the congress, as well as their families, during the communist regime in Albania (1945–1991). This period, characterized by political repression and ideologically driven historical revisionism, saw many contributors to national identity-building excluded from official narratives, while their relatives often faced persecution and marginalization. The study focuses on three core aspects: the delegates’ role in

shaping Albanian cultural identity; the treatment of their families under the regime; and the post-1945 efforts to erase or distort their historical legacy. The research is grounded in previously unexplored archival materials and oral testimonies from direct descendants. This approach seeks to restore attention to figures marginalized by ideology and reflect critically on how totalitarian regimes manipulate national history. The paper contributes to a deeper understanding of memory, identity, and political influence on historiography in post-Ottoman and post-ideological Albania.

Keywords: *Congress, Delegates, communist regime, national identity, archival sources.*

Hyrje

Në kushtet kur shqipja ende shkruhej me disa alfabete, problemi imediat ishte unifikimi i tyre.²³⁰ Kongresi i Manastirit, i mbajtur nga data 14 deri më 22 nëntor 1908, përfaqëson një moment historik në historinë kombëtare shqiptare. Ky kongres mbledhi figura kryesore intelektuale dhe kombëtare për të unifikuar alfabetin e gjuhës shqipe, një akt i domosdoshëm për konsolidimin e identitetit kombëtar dhe zhvillimin kulturor. Në këtë Kongres morën pjesë delegatë nga të gjitha trevat pa dallim feje, krahine apo ideje. Mirëpo, pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, historia e kësaj ngjarjeje dhe kontributet e delegatëve iu nënshtruan një tjetërsimi të plotë. Ky punim trajton rolin historik të delegatëve, represionin ndaj pasardhësve të tyre dhe përplasjen ideologjike të regjimit me figurat patriotike, si dhe përpjekjet për të eliminuar trashëgiminë e tyre nga kujtesa kombëtare.

Roli i Delegatëve të Manastirit në Formësimin e Identitetit Kombëtar

Kongresi i Manastirit u mbledh në një periudhë kur kombi shqiptar ndodhej në një krizë identitare dhe politike. Delegatët e Kongresit, që vinin nga trevat shqiptare dhe diaspora, u bashkuan për të zgjidhur një problem thelbësor: unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Në kongres u propozuan alfabete të shumta si ai i Sami Frashërit me germa arabe, alfabeti i Shoqërisë "Agimi" dhe ai i Shoqërisë "Bashkimi". Pasi nuk u arrit në përcaktimin e një alfabeti të vetëm, u vendos që në përdorim të ishim dy alfabete, ai i Stambollit dhe ai i Shoqërisë "Bashkimi".²³¹

Përmes diskutimeve të gjera dhe debatit intelektual, ata vendosën që alfabeti latin të bëhej baza e shkrimit shqip. Ky vendim nuk ishte vetëm praktik, por edhe strategjik, pasi e orientonte Shqipërinë drejt Perëndimit dhe larg ndikimit osman.

Gjergj Fishta, i njohur si figura kryesore e letërsisë shqiptare dhe autor i epopeve kombëtare si "Lahuta e Malcis", ishte një nga mbështetësit kryesorë të alfabetit latin. Ai i dha Kongresit një dimension kulturor dhe artistik. Në revistën Hylli i Dritës me rastin e 25 vjetorit të Kongresit të Manastirit, 1938, shkrimi i Antonin Fishtës jep rolin parësor të At Gjergj Fishtës në caktimin e alfabetit dhe atmosferën përpajtuese mes dy rrymave²³² "fjalimi qi mbajti Gjergj Fishta, permi ransi të nji Alfabeti të përbashkëtë, qi mund do t' ishte njiherit eshe porsi nji tip bashkimi e lidhnijet ndërmjet zemrave shqyptare, pa shikjue largësi krahinash as dasi dialektesh as besimesh, aq i tranoi e i përmalloi të gjithë pjesëtarët e Kongresit, sa tanë nji zanit danë me zgjedhë nji Komisjon të posaçëm prej 11 vetash për nji studim ma t' imët e kthellhtë të ksajë çastje e për Kryetar kje emnue Gjergj Fishta e Nënkyetar Luigj Gurakuqi"

²³⁰ Historia e shqiptarëve gjatë shek XX, Botimet albanologjike, 2017, vëll I, f. 90

²³¹ Po aty, f. 91

²³² Hylli i Dritës, 1938, f.

Po ashtu, Mit'hat Frashëri, me formimin e tij intelektual dhe angazhimin politik, kontribuoi në orientimin ideologjik të kongresit. Figura të tjera si Bajo Topulli, Luigj Gurakuqi dhe Sotir Peci luajtën gjithashtu role kyçe duke përfaqësuar pjesë të ndryshme të shoqërisë shqiptare.

Represioni ndaj Familjarëve të Delegatëve në Regjimin Komunist



Pas instalimit të regjimit komunist në vitin 1945, trajtimi i figurave historike të Kongresit të Manastirit ndryshoi rrënjësisht. Regjimi filloi një fushatë sistematike për të denigruar dhe eliminuar kontributet e tyre, duke ndërmarrë represion ndaj familjarëve dhe trashëgimtarëve të tyre.

²³³Foto 1. 1. Midhat Frashëri, 2. Gjergj Fishta, 3. Emzot Kaçori, 4. Dom Nre Mjeda, 5. Gjergj

Qiriaz, 6. Fehim be Zavalani, 7. Dimitri Mole, 8. Nyzhet Vrioni, 9. Rok Berisha, 10. Bajo Topulli, 11. Thoma Abrami, 12. Sotir Peci, 13. Luigji Gurakuqi, 14. Shahin Kolonja, 15. Ahil Eftim Korça, 16. Adham Shkaba Statobërdha, 17. Dimitri Buda, 18. Mati Logoreci, 19. Azis Starova. 20. Shevqet Frashëri, 21. Simon Shuteriqi, 22. Leonidha Naçi, 23. Zejnel Glina, 24. Sami Pojani, 25. Refik Toptani, 26. Çerçiz Topulli, 27. Mihal Grameno, 28. Muhtari shok i Çeços, 29. Akil Efthim, 30. Xhelal be Poda. *Mungojnë në foto:* Hil Mosi, Grigor Cilka, Hafez Ibrahim dhe Emin Beu. Rauf Beu dhe Selahedin Beu nga Prizreni.



²³⁴Foto 2. Foto e ritishuar - hequr imazhet e Mitat, Frashërit, Gjergj Fishtës dhe Azis Starovës: nr. 1, 2, 19. sipër të origjinalit

Ajo c'ka dëshiroj të theksoj është fakti se regjimi komunist nuk i përdoqi këto figura se ishin pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit po për faktin që në Shqipërinë e viteve Komuniste lufta për pushtet ishte aq e egër sa nuk kurseu dhe heqjen e meritave të disa prej këtyre delegatëve. Figura e Mit'hat Frashërit pavarësisht meritës në Kongresin e Manastirit ku ishte i zgjedhur dhe Kryetar i Komisionit të caktimit të Alfabetit regjimi Komunist që në momentet e para të marrjes së pushtet e

²³³ Gazeta Dituria, botues Mitat Frashëri, Selanik, Nr. 3, 1909. f. 41+.

²³⁴ Ibrahim D. Hoxha, "Nëpër udhët e penës shqiptare", Tiranë 1986, f. 210

cilëson figurën e Frashërit si; Përgjegjës për politikën kolaboracionste të kësaj organizate me okupatorët fashistë italianë dhe gjermanë.²³⁵ Në veprën e tij në një fragment drejtuar Presidentit Amerikan Harry Truman, dt. 1 qershor 1945, E. Hoxha shkruan; {...} kriminelët më të poshtër shqiptarë të luftës, si: Ali Këlcyra, Mithat Frashëri, Abaz Kupi, Kadri Cakrani, Koço Muka, Vehip Runa e shumë të tjerë, në vend që të mbahen në kampet e përqendrimit dhe të trajtohen si armiq duke marrë parasysh bashkëpunimin e tyre të vendosur me nazistët gjermanë, ata trajtohen në mënyrën më të favorshme dhe lihen të lirë në qytetet e Italisë {...} *²³⁶

Familja e Gjergj Fishtës ishte në qendër të sulmeve ideologjike. Fishta u shpall "armik i popullit", dhe veprat e tij u ndaluan të botoheshin ose të studioheshin. Bibliotekat private që ruanin dorëshkrimet e tij u konfiskuan, dhe familjarët e tij u internuan. At Konrad Gjollaj: "Me "revolucionin kulturor" edhe eshtrat e Tij u tretën buzë Drinazës, në afërsi të Bërdicës, bashkë me eshtrat e vëllezërve të tjerë t'asaj Kishe".

Vendvarrimi i Fishtës ndodhej në Kishën e Fretënve Françeskanë në Gjuhadol. Kisha u tjetërsua në Kinema "Punëtori" dhe eshtrat e etërve u zhvarrosën e u hodhën në bashkimin e lumejve Drin e Bunë.

Në vitin 1998, me rastin e rikthimit në identitet të Kishës së Gjuhadolit u kryen punime ne dyshemenë e kishës. At Zef Pëllumbi duke e ditur pozicionin e varrit të Fishtës drejtoi punimet e kërkimit të eshtrave. u gjerten disa kostola te cilat jane ekspozuar në Muzeun e Kishës. Në veprën e tij Enver Hoxha shprehej; "Armiqtë e popullit tonë kanë pas ngritur në sistem ndjenjën e shovinizmit e të nacionalizmit të kalbur borgjez dhe tradhëtarët e spiunët si Gjergj Fishta e të tjerë, tërë jetën, e tyre kanë punuar të na ndajnë e të na armiqësojnë me ata popuj, me të cilet ne ishim vëllezër dhe që në ditët e para të luftës sonë u bashkuam me gjithë forcat tona."²³⁷

Regjimi komunist i Shqipërisë, nëpërmes ideologjisë së tij marksiste-leniniste, nisi një proces të gjerë të tjetërsimit të historisë kombëtare. Figura si Gjergj Fishta, që dikur vlerësoheshin si shtylla të kulturës kombëtare, u shpallën armiq të shtetit. Emrat e tyre u hoqën nga librat e historisë, dhe veprat e tyre u ndaluan.

Gjergj Fishta, autor i disa prej kryeveprave të letërsisë shqipe, u konsiderua një pengesë për ideologjinë komuniste. Veprat e tij, si "Lahuta e Malcis", u cilësuan si reaksionare dhe u zhdukën nga qarkullimi. Regjimi komunist ishte aq i egër sa që nuk kurseu të dënojë dhe ata persona të cilët përkrahnin veprat e Fishtës, sic ishte rasti i Mark Ndojës ku në 24 dhjetor 1945 dënohet me 6 vite heqje lirie.²³⁸

☞ Lef Nosi 1908 Pjesëmarrës në Kongresin e Manstirit. Me një veprimtari të gjërë politike ku në 1912 emërohet Ministër i Postë Telegrafës dhe në 1919 me propozimin e At Gjergj Fishtës emërohet Ministër për ushqimin në qeverinë e Durrësit. Në 1940 zgjidhet me propozimin e Ethem Haxhiademit Kryetar i Ballit Kombëtar për Elbasanin. Ndërsa në tetor 1943 zgjidhet Kryetar i Asamblesë ku shpallet neutraliteti i Shqipërisë dhe shkëputja nga Perandoria e Italisë. Pas marrjes së pushtetit nga Komunistët ai në 12 prill 1945 dënohet me vdekje së bashku me At Anton Harapin dhe Maliq Bushatin. Në Gjyqin Special, Vendimi 12 shkurt 1945 e dënon atë me vdekje.²³⁹ Në veprën e III të tij E. Hoxha shprehet; Shpejt do të dalin në gjyq tri nga fytyrat më të poshtra të tradhëtisë së madhe që ju bë popullit shqiptar gjatë gjithë historisë së tij; Pater Anton Harapi, Lef

²³⁵ AMPJ, Viti 1947, Kutia 8, D. 159, fl. 123. "Lista e kriminelëve të luftës shqiptare"

²³⁶ E. Hoxha: "Vepra", Vol. 3, 8 Nëntori, Tiranë, 1969, f. 57.

²³⁷ E. Hoxha, "Vepra 4", 8 Nëntori, Tiranë 1970, f. 413-414

²³⁸ AMPB, F. 1, D. 4739, Fl. 58

²³⁹ AMPB, F. 1, D.1086, fl. 391

Nosi dhe kryeministri kuisling Maliq Bej Bushati”²⁴⁰. Fondi i Lef Nosit i sekuestruar arkivor në AQSH është tepër i gjerë me rreth 70 dosje me krijimtari, përmbledhje studimesh albanologjike, leksikologji dhe folklor.

Konkluzione

Kongresi i Manastirit mbetet një nga momentet më të lavdishme të historisë kombëtare shqiptare, por fati i delegatëve të tij dhe pasardhësve të tyre reflekton sfidat e trashëgimisë sonë kulturore. Regjimi komunist jo vetëm që përndoqi familjet e tyre, por u përpoq të shuante edhe kujtesën historike, duke tjetërsuar kontributet e këtyre figurave. Nëpërmjet këtij punimi sot mund të rikthejmë vlerësimin ndaj tyre dhe të njohim kontributin e pashlyeshëm të delegatëve të Manastirit.

Në këtë cikël të ndriçimit të misëve të Kongresit të Manastirit, personaliteteve dhe familjeve të tyre, kontribues të Rilindjes Kombëtare, trajtojmë atë pjesë të historisë që është heshtur për 4-5 decenie - historia si përndjekje dhe anatemie gjatë regjimit komunist. Dhe pikërisht Kongresi i Manastirit për caktimin e alfabetit unik që maja e përpjekjeve të intelektit shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare. Pas vitit 1944, u përhap ideja e fitimtarëve dhe sunduesve të rinj të veshur me ideologjinë leniniste - se çdo gjë arrihet me revolucion. Aspekte të këtij “revolucion” u shfaqën në qëndrimin e regjimit të ri - përmes promemorieve të KQ të PPSH - kundër traditës dhe eventeve historike të kaluara të ngulitura në memorien kolektive.

Referenca

Arkivi

AMPB, F. 1, D. 4739

AMPB, F. 1, D.1086

AMPJ, Viti 1947, Kutia 8, D. 159, fl. 123. “Lista e kriminelëve të luftës shqiptare”

Gazeta & Revista

Gazeta Dituria, botues Mitat Frashëri, Selanik, Nr. 3, 1909

Hylli i Dritës, 1938,

Literaturë

E. Hoxha “Vepra 3”, Vol. 3, 8 Nëntori, Tiranë, 1969

E. Hoxha, Vepra 4, 8 Nëntori, Tiranë 1970

Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX, Botimet albanologjike, 2017, vol. I

Ibrahim D. Hoxha, “Nëpër udhët e penës shqiptare”, Tiranë1986